



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:260657

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830659

C.nr.2549/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Liridona Haziri-Mustafa, me bashkëpunëtorin profesional Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditëses V.Q. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i orëve mësimore mbinormë, me vlerë të kontestit 1,600.85 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 12.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.Q. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit për orët mbinormë për periudhën kohore sipas vitit shkollor 2021/22 deri më datë 21.11.2022, duke llogaritur për 73 javë nga 2 orë mbi normë jashtë orarit të punës për 30 % rritje të pagës bazë prej 421.00 euro, për gjithsej 146 orë mësimore mbi normë, t'ia paguaj shumën prej 996.08 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 27.11.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar për periudhën 01.01.2020 – 27.11.2020, në shumën e përgjithshme prej 604.77 euro.

III. DETYROHET e paditura që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditëses në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 27.11.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, për kompensimin e orëve mësimore mbinormë, me vlerë të kontestit 1,600.85 euro.

Në padi dhe precizim të kërkesëpadiisë të datës 31.01.2024 ka theksuar se paditësja është e punësuar në pozitën e mësimitdhënës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “Selami Hallaçi”, ndërsa nuk është kompensuar nga e paditura për orët e realizuara mbi normë, përkundër se e njëjta ka qenë në detyrë të këtij detyrimi. Ka shtuar se paditësja për periudhën 01.01.2020 – 21.11.2022, ka punuar gjithsej 117 javë nga 2 orë, për gjithsej 234 orë mësimore mbi normë jashtë orarit të punës. Llogaritjen e ka bazuar mbi vlerën prej 30 % të pagës bazë sipas orëve mësimore mbi normë për këtë periudhë. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadiinë e paditësës në shumën prej 1,600.85 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilimin e padisë; 104.00 euro, për precizimin e padisë; dhe 30.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 05.03.2024 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim, inflacion, kalsë të kombinuara, puna mbi normë dhe performancë, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i punës mbinormë, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Lidhur me shpërblimin vjetor sipas vlerësimit të performancës, ka konsideruar se zbatimi i kësaj mase lidhet me përmirësimin e performancës së sistemit, ku nga rezultatet e testit PISA konstatohet se nuk ka përmirësim, e madje rënie të performancës. Sa i përket kompensimit për punë me klasë të kombinuara, ka theksuar se kjo çështje nuk rregullohet me asnjë dispozitë ligjore dhe zbatohet kur një mësimitdhënës nuk mund të përmbush normën mësimore, por gjithëherë orët të janë të ciklit klasor. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadiinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadiia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse te e paditura (kontrata e punës për kohë të pacaktuar, nr.prot.156 e dt.01.09.2015 dhe vërtetimi nr.prot.503-19 i dt.05.12.2023 i lëshuar nga SHFMU “Selami Hallaçi” në Gjilan).

Nuk është kontestuese se për vitin shkollor 2020/21 ka realizuar 78 orë mbinormë (39 javë x 2 orë = 78 orë), për vitin shkollor 2021/22 ka realizuar 80 orë mbinormë (40 javë x 2 orë = 80 orë) dhe për vitin shkollor 2022/23 i ka realizuar 76 orë mbinormë (38 javë x 2 orë = 76 orë), fakt të cilin gjykata e vërtetoi nga vërtetimi nr.prot.153/2023 i dt.12.04.2023 i lëshuar nga SHFMU “Selami Hallaçi” në Gjilan); e as nuk është kontestuese se paga bazë e së njëjtës është 421.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provën në shkresat e lëndës e gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi e njëjta është lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këtë dokumente.

Për vendosje këtë çështje kontestimore, gjykata zbatoi dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 56, paragrafi 2, pika 2.2 se “Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë 30 % në orë për punë jashtë orarit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 11, paragrafi 2 se “Ngarkesa mësimore javore e mësimdhënësve në nivelin parauniversitar është 20 orë mësimi në javë”; paragrafi 10 se “Mësimdhënësit paguhen në bazë të normës së punës”; dhe paragrafi 13 se “Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë mbinormë, të paguar deri në 30 % të ngarkesës mësimore”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata ka gjetur se paditësja sipas kontratës së punës, orë të rregullta mësimore ka 20 orë në javë (fakt i provuar nga kontrata e punës si më lartë). Këtë ngarkesë mësimore javore e përcakton edhe kontrata kolektive e arsimit. Përkundër kësaj, e njëjta ka punuar me ngarkesë mbinormë, pra ka mbajtur orë mësimore përtej 20 orëve në javë (fakt i provuar nga vërtetimi i lëshuar nga shkolla në fjalë), ndërsa e paditura nuk e ka kompensuar për këtë ngarkesë (orët mbinormë) paditësen me 30 % të pagës së rregullt bazë.

Gjykata vlerëson se e paditura bazuar në nenin 56.2, pika 2.2 të LP-së dhe nenit 11.13 të KKAK-së, e paditura ka pasur për obligim që t'i paguajë mësimdhënësit e saj me 30 % pagë shtesë të pagës bazë për punën e realizuar mbinormë.

Meqë e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj, gjykata vendosi t'ia aprovojë pjesërisht të bazuar kërkesën paditëse, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që për vitin shkollor 2021/22 deri më datë 21.11.2022, të llogaritura për 73 javë (40 javë për vitin shkollor 2021/22 dhe 33 javë për vitin shkollor 2022/23), me gjithsej 146 orë mbinormë (të llogaritura 73×2), për 30 % pagë shtesë të pagës bazë ($421 \times 30\% = 126.30$; $421 + 126.30 = 547.30$), arrijnë shumën prej 996.08 euro ($146 : 80$ orë mësimore për një muaj = $1.82 \times 547.30 = 996.08$).

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjykata vlerësoi këtë pretendim dhe gjeti se kërkesa e paditëse është pjesërisht e parashkruar. Bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat monetare nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 vite. Në këtë rast, paditësja ka paraqitur padinë më datë 27.11.2023, prandaj edhe llogaritja e kërkesës së saj duhet të jetë nga data 27.11.2020, kurse pjesa tjetër 01.01.2020 – 27.11.2020, është e parashkruar.

Për këtë arsye, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në mungesë të provave për të vërtetuar saktë se sa janë orët mbinormë të paditëse që ka punuar nga data 27.11.2020, ia njohi vetëm orët mbinormë sipas vitit shkollor 2021/22, me të cilat provohet saktësisht se sa orë mbinormë ka punuar paditësja në këtë shkollë. Gjykata vlerëson se është obligim i palëve në proces të mbështesin me prova konkrete faktet e tyre, e në këtë rast, në mungesë të provave për të vërtetuar orët mbinormë që nga kjo datë, gjykata bazuar në nenin 7 të LPK-së, ia refuzoi pjesën tjetër për të cilën nuk vërtetohet se sa orë mbinormë ka punuar paditësja te e paditura.

Sa i përket kundërshtimeve në përgjigje në padi të paditurës se paditëse nuk i takon e drejta në këtë kompensim, gjykata e gjeti të pabazuar edhe nga neni 56.1 i Ligjit të Punës që përcakton se “Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëse në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës. Sa i përket precizimit të padisë, të njëjtën nuk e konsideroi shpenzim të nevojshëm për ndjekjen e çështjes në gjyq, meqë padia ka mund të iniciohet e precizuar qysh në fillim, prandaj nuk ia njohi këtë shpenzim.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2549/23, datë 12.06.2024

Gjyqtarja,
Liridona Haziri-Mustafa

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.